



## Disiplina e Sufizmit

### Description

#### Ibn Haldun

Fragment i shkeptur nga libri i mirënjohur i Ibn Haldunit, “El-Mukadimeh”, edicioni kritik nga Abdullah Muhamed el-Dervish, vëll. II, fq. 225-242

Kjo disiplinë i përket disiplinave të Sheriatit dhe e ka origjinën në Islam. Sufizmi mbështetet në presupozimin se metoda e atyre njerëzve (që më pas u njohën si sufist) ka qenë konsideruar gjithnjë nga myslimanët e rëndësishëm dhe të hershëm – njerëzit që qendronin përreth Muhamedit (a.s.) (sahabët) dhe ata të gjeneratës së dytë (tabiinët) si edhe ata që erdhën pas tyre – si rruga e të vërtetës dhe udhëzimit në rrugë të drejtë. Qasja sufiste mbështetet mbi aplikimin konstant të adhurimit, përkushtimit të plotë ndaj Zotit, refuzimit të shkëlqimit të rremë të botës, abstenimit nga kënaqësia, pasuria dhe pozita, të cilat kërkohen kaq shumë nga masat, si edhe tërheqjen nga kjo botë për në vetminë e adhurimit. Këto gjëra ishin përgjithësisht (të pranishme) tek sahabët dhe myslimanët e hershëm.

Pastaj, duke filluar nga shekulli i dytë hixhri (shek. 8) e më pas aspiratat ndaj dynjasë u rritën. Njerëzit filluan të prireshin drejt çështjeve të dynjasë. Në atë kohë, emri i përveçëm i sufive (Sufijeh dhe Mutesauifeh) iu dha atyre që aspironin drejt adhurimit. El-Kushejri thotë: “Në gjuhën arabe asnjë etimologji apo analogji nuk mund të gjendet për këtë term. Është e qartë se ky term është një titull (llagab). Teoritë që e derivojnë këtë fjalë nga fjala el-safa (pastërti, sinqeritet), ose nga fjala el-Suffah (qoshk), apo el-saff (rresht) janë të pagjasa nga këndvështrimi i analogjisë gjuhësore”. El-Kushejri vazhdon: “E njëjta gjë i aplikohet derivimit të këtij termi nga fjala el-suf (lesh), sepse sufite nuk ishin të vetmit që vishnin rroba leshi”.

Unë them: Etimologjia me e mundshme është ajo që lidh fjalën sufizëm me fjalën el-suf (lesh), sepse sufite si normë karakterizohen nga fakti se veshin rroba leshi. Ata kundërshtonin njerëzit që vishnin rroba të shtrenjta dhe kështu vendosën të veshin rroba leshi.

Sufite u bënë përfaqësues të asketizmit, tërheqjes nga dynjaja dhe të përkushtimit ndaj adhurimeve. Më pas, ata zhvilluan një perceptim të veçantë i cili vjen përmes përvojës ekstetike (mauxhid). Këto përvoja lindin si më poshtë: Njeriu si njeri është i dalluar nga të gjitha kafshët përmes aftësisë së tij për të perceptuar. Perceptimi i tij është dy llojesh: Ai mund të perceptoj shkenca dhe çështje ditunore dhe

këto mund të jenë të sigurta, hipotetike, të dyshimta apo imagjinare. Ai po ashtu mund të perceptojë “gjendje” që persistojnë në vetvete si p.sh. gëzimi dhe trishtimi, ankthi dhe relaksimi, kënaqja, zemërimi, durimi, mirënjohja etj... Pjesa arsyetuese aktive në trup buron nga perceptimet, vullnetet dhe gjendjet. Është përmes tyre që njeriu dallohet nga kafshët e tjera, siç e përmendëm pak më parë. Ato burojnë nga njera-tjetra. Kështu, dija buron nga prova, trishtimi dhe gëzimi nga perceptimi i asaj që është e dhimbshme apo e kenaqshme, energjia buron nga pushimi dhe mugesia e lëvizjes nga të qenit i lodhur. Në të njëjtën mënyrë, ushtrimi dhe adhurimi i muridit sufi dërgon domosdo në një “gjendje” që është rezultat i ushtrimit të tij. Kjo gjendje mund të jetë një lloj adhurimi, i cili më pas do të ngulitet thellë tek muridi dhe do të shndërrohet në një “vendqendrim” (mekam) për të. Ose, gjendja mund të mos jetë një lloj specifik adhurimi, por thjesht një atribut që ndikon shpirtin si p.sh. gëzimi apo mirënjohja, energjia apo amullia apo diçka tjetër.

Vendqendrimet formojnë një rend ngjitës. Muridi vazhdon të përparojë nga një vendqendrim në tjetrin derisa arrin të kupturit e unitetit të Zotit (teuhid) dhe gnosën (ma’rifeh) e cila është objektivi i dëshiruar i lumturisë. Muhamedi (a.s.) ka thënë: “Cilido qe vdes duke thënë “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut do të hyj në Xhenet (Parajsë)”

Kësisoj, muridi duhet të përparojë përmes këtyre staveve. Baza e të gjitha atyre është bindja dhe sinqeriteti. Besimi (Imani) i paraprindit dhe shoqëron të gjithë vendqendrimet. Rezultati dhe frutet e tyre janë gjendjet (ahual) dhe atributet. Ata e dërgojnë tek vendqendrimet të tjera e më pas tek të tjera akoma derisa mbërrin tek realizimi i njëshmërisë së Zotit dhe gnosës (irfan). Nëse rezultati tregon ndonjë mangësi apo defekt duhet të jemi të sigurt se kjo vjen nga disa mangësi që ekzistojnë në statet e mëparshme. E njëjta gjë i aplikohet edhe idesë së shpirtit dhe inspirimit të zemrës.

Kësisoj, muridi duhet të *analizoj vetveten* (muhasabah) në të gjitha veprimet dhe të studioi ndikimin e tyre të fshehur, sepse rezultatet detyrimisht burojnë nga veprimet dhe mangësitë në rezultate burojnë automatikisht nga defektet në veprime. Muridi e zbulon këtë të vërtetë përmes përvojës së tij mistike dhe ai analizon veten në lidhje me arsyet që dërguan në një rezultat të tillë.

Shumë pak njerëz kanë të njëjtën vetë-analizë si sufite, neglizhenca (e njerezve) në këtë aspekt është pothuajse universale. Njerëzit e devotshëm që nuk shkojnë kaq larg performojnë, në rastin më të mirë, akte bindjeje të shilruara nga studimi juridik i mënyrës se si këto vepra duhet të jenë të kënaqshme dhe konforme (gjatë aktit të ekzekutimit të adhurimit). Megjithatë, sufite hetojnë rezultat e aktit të bindjes me ndihmën e përvojës mistike dhe ekstatike, në mënyrë që të mësojnë nëse janë, apo jo, këto vepra të shpirtit nga mangësitë. Kësisoj, është e qartë se rruga e sufive varet plotësisht mbi vetë-analizën në lidhje me atë që ata duhet të bëjnë apo të mos bëjnë dhe mbi diskutimin e përvojave të ndryshme mistike dhe ekstatike që përvetësojnë prej ushtrimeve të tyre shpirtërore. Më pas, për muridin kjo kristalizohet në një “vendqendrim”. Prej këtij vendqendrimi ai mund të përparojë drejt një tjetër vendqendrimi më të lartë.

Mbi të gjitha, sufite kanë sjelljen e tyre të veçantë dhe terminologjinë e tyre gjuhësore të veçantë të cilën e përdorin gjatë mësimdhënies. Të dhënat gjuhësore aplikohen vetëm ndaj ideve përgjithësisht të pranuar. Kur shfaqen ide jo përgjithësisht të pranuar, atëherë krijohen terma teknik për të lehtësuar kuptimin e këtyre ideve.

Prandaj, sufite krijuan disiplinën e tyre të veçantë, e cila nuk diskutohet nga përfaqësues të tjerë të ligjit fetar. Si pasojë, disiplina e ligjit fetar filloi të përbëhej prej dy llojeve. Njera është fusha e veçantë e juristëve dhe myftinjve. Ajo preokupohet me ligjet e përgjithshme që udhëheqin aktet e adhurimit, veprimet zakonore (urf) dhe transaksionet (muamelat). Tjetra është fusha e veçantë e sufive (*kaum*). Ajo preokupohet me përpjekjen e devotshme (muxhahahadah), vetë-analizën në lidhje me to,

diskutimin e llojeve të ndryshme të përvojës mistike dhe ekstatike që ndodh përgjatë (vetë-analizës), mënyra e ngjithjes nga një përvojë mistike tek tjetra dhe interpretimin e terminologjisë teknike të misticizmit që përdoret midis tyre.

Kur disiplinat Islame filluan të shkruheshin në mënyrë sistematike dhe kur juristët filluan të shkruanin vepra në jurisprudencë (fikh), në principet e jurisprudencë (usul fikh) si edhe në teologjinë spekulative (kelam), interpretimin e Kuranit (tefsir) dhe subjekte të tjera, atëherë edhe sufitetë filluan të shkruanin në lidhje me sufizmin. Disa sufi shkruan rreth ligjeve që udhëheqin asketizmin dhe vetë-analizën, si të veprohet dhe të mosvetrohet në përputhje me imitimin e modeleve (evlijave). Një gjë e tillë u krye nga el-Muhasibi në librin e tij “Kitab el-Ri’ajeh”. Te tjerë autorë sufi shkruan rreth sjelljes të sufive dhe llojeve të ndryshme të përvojës mistike dhe ekstatike në “gjendjet” (ahual). El-Kushejri në veprën e tij “Kitab el-Risaleh” dhe el-Suhraëardi në librin e tij “Kitab auarif el-mearif” si edhe të tjerë shkruan pikërisht rreth kësaj gjëje.

Imam Gazali i bashkoi këto dy tema në librin e tij “Ihja Ulum el-Din”. Në të, ai u morr në mënyrë sistematike me ligjet që udhëheqin asketizmin dhe imitimin e modeleve. Më pas, ai shpjegoi sjelljen dhe zakonet e sufive dhe komentoi fjalorin e tyre teknik.

Në këtë mënyrë, disiplina e sufizmit u bë një disiplinë sistematikisht e trajtuar në Islam. Para kësaj periudhe, misticizmi konsistonte thjesht në adhurim dhe ligjet që e udhëheqnin atë gjendeshin në kraharoret e njerëzve. E njëjtë ka qenë situata me të gjitha disiplinat e tjera si p.sh. interpretimi i Kuranit (tefsir), shkenca e hadithit, jurisprudenca (fikhut), parimet e jurisprudencës (usul fikhut) dhe disiplinat e tjera. Vetëm më pas këto disiplina u trajtuan në mënyrë sistematike.

Si rregull, përpjekja shpirtërore (muxhahada), izolimi dhe ushtrimet e dhikrit ndiqen nga heqja e velit (keshf) të perceptimit ndjesor. Sufiu vë re botëra hyjnore të cilat një person nën shqisat nuk mund ti rrokë aspak. Shpirti i përket atyre botëve. Arsyeja për heqjen e velit është si më poshtë: Kur shpirti kthehet nga perceptimi ndjesor i jashtëm drejt perceptimit ndjesor të brendshëm, shqisat dobësohen dhe shpirti rritet në fuqi. Ai fillon të mbizotëroj dhe të marrë një rritje të re. Ushtrimet e dhikrit ndihmojnë në arritjen e kësaj gjëje. Dhikri është si ushqim që e bën shpirtin të rritet. Shpirti vazhdon të rritet e të shtohet. Ai ishte dije ndërsa tani bëhet vegim. Veli i shqisave perceptuese hiqet dhe shpirti kupton ekzistencën e tij thelbësore. Kjo është identike me perceptimin. Shpirti tani është gati për dhuratat hyjnore (*meuahib el-rabanijeh*) për dijet e pranisë hyjnore dhe për hapjet hyjnore (*fet’h el-ilahi*). Esenca e tij kupton karakterin e tij të vërtetë dhe afrohet më sferat e larta, sferat e engjejve. Heqja e velit i ndodh shpesh atyre që e ushtrojnë veten në përvojën mistike. Ata e përjetojnë realitetin e ekzistencën si askush tjetër.

Ata po ashtu ndjejnë në avancë ndodhitë e ardhshme. Me ndihmën e mendjes dhe fuqive të tyre psiqike ata janë aktivë midis ekzistencave të ulta të cilat më pas bëhen të bindura ndaj vullnetit të tyre. Sufitetë e mëdhenj nuk i kushtojnë shumë rëndësi heqjes së velit dhe aktivitetit midis ekzistencave të ulta. Ata nuk kanë dhënë asnjë informacion rreth realitetit të asgjëje për të cilën nuk janë urdhëruar që të diskutojnë. Kur gjëra të tilla i ndodhin atyre ata e konsiderojnë atë si fitne dhe përpiqen të arratisën prej një gjëje të tillë saherë që ajo i ndodh.

Njerëzit përreth Muhamedit (a.s.) praktikonin këtë lloj përpjekjeje shpirtëore (muxhahada). Ata kishin një hise të bollshme në aktet e hirit hyjnor (keramente), por ato nuk i jepnin rëndësi. Përshkrimet e virtyteve të Ebu Bekrit, Umerit dhe Aliut përmbajnë shumë informacione në lidhje me këtë gjë. Këta (kalifë të drejtë) u ndoqën në shumë aspekte nga sufitetë të cilët janë përmendur në veprën el-Risaleh të Imam Kushejrit si edhe nga pasardhësit e tyre të mëvonshëm.

Më pas, sufitetë e mëvonshëm e kanë kthyer vëmendjen e tyre tek heqja e velit (keshf) dhe diskutimi i perceptimeve përtej ndjesive shqisore. Në këtë aspekt, rrugët e ushtrimit të tyre shpirtëror janë të ndryshme. Ata kanë mësuar metoda të ndryshme të ndrydhjes së fuqive të perceptimit shqisor dhe ushqimit të shpirtit me ushtrimet shpirtërore, në mënyrë që shpirti të rritet plotësisht dhe të arrijë perceptimin e tij thelbësor. Kur një gjë e tillë ndodh, ata besojnë se e gjithë ekzistenca përfshihet nga perceptimi i shpirtit, esencat e ekzistencës i zbulohen atyre dhe se ata përjetojnë realitetin e të gjithë esencave që nga arshi hyjnor deri tek shiu i lehtë. Kjo është thënë nga Imam Gazali në librin e tij "Ihja Ulum el-Din" pasi ai përmend format e ushtrimeve shpirtërore.

Sufitetë nuk e konsiderojnë të saktë heqjen e velit (keshf) nëse ai nuk buron nga të qenit i drejtë (istikamah). Njerëz që nuk hajnë dhe që tërhiqen nga bota si p.sh. magjistarët, të krishterët dhe asketët të tjerë mund të arrijnë në heqjen e velit pa ekzistencën e istikames. Sidoqoftë, ne kemi për qëllim vetëm atë heqje veli e cila buron nga të qenit i drejtë. Kjo mund të krahasohet me reflektimin e një pasqyre. Nëse është e mysët apo e lugët, objekti i reflektuar prej tij do të shfaqet në një formë të shtrembëruar të ndryshme nga forma aktuale e objektit, por nëse pasqyra është e sheshtë atëherë objekti do të shfaqet në formën e tij të saktë. Për sa i përket "gjendjeve" që lënë gjurmë në shpirt, istikameja nënkupton për shpirtin atë që sheshtësia nënkupton për pasqyrën.

Sufistetë e mëvonshme që e kanë preokupuar vetën me këtë lloj heqjeje veli flasin për karakterin e vërtetë të ekzistencave të larta dhe të ulta dhe rreth karakterit të vërtetë të mbretërisë hyjnore, shpirtit, fronit hyjnor, kursijit dhe gjërave të ngjashme. Ata që nuk ndajnë me ta këtë qasje nuk ishin të aftë të kuptonin përvojat e tyre mistike dhe ekstatike në lidhje me këtë aspekt. Myftinjët pjesërisht i kanë refuzuar këto lloj sufish dhe pjesërisht i kanë pranuar ata. Argumentet dhe provat nuk shërbejnë për gjë në të vendosurit nëse qasja sufiste duhet refuzuar apo pranuar, duke qenë se një gjë e tillë i përket përvojës intuitive.

*(Më pas Ibn Khalduni shtjellon në mënyrë të detajuar lindjen e ideve të uahdetul uxhud (njeshmerisë së qenies) dhe idesë së qutbëve (evlijave shtylla që pasojë njeri-tjetrit) në Sufizmin e mëvonshëm teosofik. Ai nxjerr në pah ndikimin e filozofisë dhe të mendimit shiit në këto konceptime të mëvonshme dhe tregon ndikimin që shiizmi dhe filozofia platonike ka pasur në sufizmin e mëvonshëm teosofik. Pas shtjellimit të hollësishëm të formulimit të këtyre koncepteve ai shprehet:)*

Shumë jurist kanë marrë përsipër të refuzojnë këto dhe pohime të ngjashme të bëra nga sufitetë. Në mënyrë përmbledhëse ata refuzojnë gjithçka që hasin në rrugën e sufizmit. E vërteta qëndron se diskutimi me sufitetë kërkon bërjen e një dallimi. Sufitetë diskutojnë katër tema. 1) Së pari, ata diskutojnë përpjekjet shpirtërore, përvojat mistike dhe ekstatike që rezultojnë prej tyre si edhe vetëkriticizmin në lidhje me veprimet personale.

Ata i diskutojnë këto gjëra në mënyrë që të arrijnë përvojat mistike, të cilat më pas bëhen një vendqendrim nga i cili individi mund të përparojë drejt një vendqendrimi tjetër më të lartë, ashtu siç e kemi shprehur më parë. 2) Së dyti, ata diskutojnë heqjen e velit (keshf) dhe realitetin e perceptuar mbinatyrore si p.sh. atributet hyjnore, arshin hyjnor, kursijin, engjejt, shpalljen, profecinë, shpirtin dhe realitetin e gjithçkaje në ekzistencë, qoftë ajo e mbinatyreshme apo e dukshme. Mbi të gjitha, ata

diskutojnë rendin e gjërave të krijuara, si ato burojnë nga Krijuesi i Cili i sjell ato në ekzistencë, siç e kemi përmendur më parë. 3) Tema e tretë ka të bëjë me aktivitetin e botëve të ndryshme dhe midis gjërave të ndryshme të krijuara të lidhur me veprime të ndryshme të hirit hyjnor. 4) Tema e katërt ka të bëjë më shprehje që janë të dyshimta nëse kutpohen në kuptimin e tyre të fjalëpërfjalshëm. Shprehje të tilla janë shprehur nga shumica e liderëve sufi. Në terminologjinë teknike sufiste ato njihen si “shprehje ekstatike” (shatahat). Kuptimi i tyre i fjalëpërfjalshëm është i vështirë për tu kuptuar.

Ato mund të përbëjnë diçka e cila duhet refuzuar, aprovuar apo diçka që kërkon interpretim.

Përsa i përket diskutimit të sufive rreth ushtrimeve shpirtërore dhe gjendjeve (ahual), të përvojave mistike dhe ekstatike që vijnë si rezultat i tyre dhe të vetëkritizimit në lidhje me mangësi të mundshme në gjërat që shkaktojnë këto përvoja, kjo është diçka që askush nuk duhet të refuzoj. Këto përvoja mistike të sufive janë të sakta. Realizimi i tyre është vetë esenca e lumturisë.

Për sa i përket diskutimit të tyre rreth akteve të hirit hyjnor (keramet) të përjetuara nga suftë, informacioni që ata japin rreth gjërave të mbinatyrshe (mugibat) dhe aktivitetit të tyre ndërmjet gjërave të krijura, edhe këto janë të sakta dhe nuk duhen refuzuar, ndonëse disa dijetarë priren ti refuzojnë ato. Kjo nuk është e drejt. Ebu Ishak el-Isfarajini, një lider i esharive, argumentonte se këto gjëra duhen refuzuar sepse ato mund të ngatërrohen më mrekullitë e profetëve. Megjithëkëtë, dijetarë kompetentë të ehli sunetit kanë bërë një dallim ndërmjet mrekullive dhe akteve të hirit hyjnor (keramete) duke iu referuar “sfidës së avancuar” (tahaddi), d.m.th. (pohimit të bërë nga një profet në avancë se mrekullitë do të ndodhin në përputhje me revelatën hyjnore. Nuk është e mundur, shprehen ata, që një mrekulli të ndodh në përputhje me pohimin e një gënjeshtari. Logjika kërkon që një mrekulli të tregoj vërtetësi. Për nga përkufizimi, një mrekulli është diçka që mund të verifikohet. Nëse ajo është kryer nga një gënjeshtar, (ajo nuk mund të verifikohet dhe kësisoj) do të këtë ndërruar karakterin e tij, gjë që është absurde. Mosaprovimi i tyre do të jetë një lloj qasjeje negative. Shumë akte të tilla hiri hyjnor (keramete) janë përjetuar nga njerëzit përreth Muhamed (a.s.) dhe myslimanët e mëdhenj të hershëm. Ky është një fakt i mirënjohur.

Shumica e diskutimeve sufite rreth heqjes së velit, marrjes së realiteteve të gjërave të larta dhe rendin sipas së cilit vijnë në ekzistencë gjërat e krijuara, në një farë mënyrë përfshihen në kategorinë e pohimeve ambivalente. Ato bazohen mbi përvojën intuitive të Sufive dhe ata të cilët nuk kanë një përvojë të tillë nuk mund të kenë përvojën mistike që kanë sufite. Asnjë gjuhë nuk mund të shpreh gjërat që sufite duan të shprehin në lidhje me këtë çështje, sepse gjuhët janë shpikur vetëm për të shprehur koncepte përgjithësisht të pranuar, shumica e të cilave i përkasin sferës së shqisave. Kësisoj, ne nuk duhet të shqetësohemi për diskutimet sufite në lidhje me këto çështje. Ne duhet thjesht ta lëmë atë ashtu siç është, njësoj siç lëmë edhe pohimet ambivalente në Kuran dhe Sunet. Ato të cilët Zoti i dhuron një farë kuptimi të këtyre shprehjeve mistike në një mënyrë të atillë që pajtohet me kuptimin e fjalëpërfjalshëm të ligjit Islam arrijnë të përjetojnë, në të vërtetë, lumturi.

Së fundmi, ekzistojnë shprehjet e dyshimta të cilat sufite i quajnë “shprehje ekstatike” (shatahat) dhe të cilat provokojnë censurën e dijetarëve të ehli sunetit. Sa i përket këtyre shprehjeve, duhet ditur se qasja e cila do të ishte e ndershme karshi sufive është që të vihet re se ata janë njerëz që janë larguar nga perceptimet shqisore. Frymëzimi i mbërthen ata. Eventualisht, ata thonë gjëra për frymëzimin e tyre që nuk dëshirojnë ti thonë. Një person që është i larguar nga perceptimet shqisore nuk mund të qortohet. Ai i cili është i detyruar të veprojë është i justifikuar (kur ai vepron, pavarësisht asaj çfarë bën). Ata sufi që janë të njohur për karakterin e tyre të shkelqyer dhe ekzemplar duhen konsideruar si persona që veprojnë me mirëbesim në këtë aspekt si edhe në aspekte të tjera. Është e vështirë të shprehësh përvoja ekstatike sepse nuk ekzistojnë rrugë konvencionale për ti shprehur ato. Kjo ishte

përvoja e Ebu Jezid el-Bistamit dhe të tjerëve të ngjashëm me të. Megjithëkëtë, ata sufi shkëlqesia karakteriale e të cilëve nuk njihet dhe nuk është e mirënjohur meritojnë të censurohen për shprehje të këtij lloji, meqenëse të dhënat që mund të na shtyjnë që ti interpetojmë pohimet e tyre (në mënyrë të atillë që të heqim cdo dyshim që lidhet me to) nuk është e qartë për ne. Mbi të gjitha, çdo sufi i cili nuk është i larguar nga perceptimet shqisore dhe nuk është nën mbërthimin e gjendjes kur shqiptojnë shprehje të tilla e meritojnë, poashtu, që të censurohen. Kështu që, juristët dhe sufritë e mëdhenj vendosën që Hallaxhi të vritet sepse ai foli në mënyrë ekstatike ndërsa nuk ishte i larguar nga perceptimet shqisore, por ishte në kontroll të gjendjes së tij. Dhe Zoti e di më së miri.

Sufitë e hershëm që janë përmendur në Risalen e Imam Kushejrit, ata myslimanë të dalluar që i jemi referuar më lart nuk kishin asnjë dëshirë që të hiqnin velin dhe të kishin një përjetim të tillë të mbinatyrshëm. Preokupimi i tyre ishte të ndiqnin modelin e tyre dhe të jetonin një jetë shembullore sa më shumë të ishte e mundur. Saherë që ata kishin një përvojë të mbinatyrshme, ata i kthenin shpinën asaj dhe nuk i kushtonin asnjë vëmendje. Në të vërtetë, ata përpiqeshin ta evitonin atë. Ata ishin të mendimit se një përvojë e tillë ishte një pengesë dhe një sprovë e cila i përkiste perceptimit të zakonshëm të shpirtit dhe për pasojë ajo ishte diçka e krijuar. Ata po ashtu ishin të mendimit se perceptimi njerëzor nuk mund të përfshijë të gjithë ekzistencën dhe se dija e Zotit ishte më e gjerë, krijimi i Tij më i gjerë dhe ligji i Tij më i sigurt për udhëzim (se sa çdo përvojë mistike). Kështu që, ata nuk flisnin për asnjë prej përvojave të tyre mistike.

Në fakt, ata e ndalonin diskutimin e këtyre gjërave dhe i ndaluan shokët e tyre, për të cilët veli i perceptimeve shqisore ishte hequr, që ta diskutonin çështjen apo ti kushtonin asaj qoftë edhe konsideratën më të vogël. Ata vazhduan të ndjekin modelet e tyre dhe të jetonin një jetë shembullore njësoj siç kishin bërë në botën e perceptimve shqisore para heqjes së velit dhe ata i urdhëruan shokët e tyre që të vepronin në të njëjtën mënyrë. E tillë duhet të jetë gjendja e muridit sufi.

Zoti dhëntë sukses.

Përktheu: Rezart Beka

**Date Created**

25/08/2016

**Author**

erasmusi